




**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
*Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority*



Nr. 37/23  
Prishtinë, më 14.04.2023

Duke u bazuar në nenet 11,13,15,16,17,18,35,51 dhe 55 paragrafi 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 14.04.2023, mori këtë:

## V E N D I M

**I. LEJOHET** Përqendrimi i ndërmarrjeve Helix Beteiligungs GmbH, Agrana Sale & Marketing për blerjen e 50% të aksioneve mbi Beta Pura.

**Helix Beteiligungs GmbH Austri**, është shoqëri e themeluar në pajtim me legjislacionin e Austrisë, me seli dhe adresë biznesi në Friedrich-Wilhelm-Raiffeisen-Plaza 1 1020 Vienna, me Nr. të regjistrimit të biznesit FN 587375 m.

**Agrana Sale & Marketing**, e themeluar në pajtim me legjislacionin e Austrisë, me adresë biznesi në Friedrich-Wilhelm-Raiffeisen-Plaza 1, A-1020 Vienna, me Nr. të regjistrimit të biznesit FN 64061h. Agrana ka edhe ndërmarrjet tjera të lidhura, Agrana Zucker, Starke und Frucht Holding AG, Austri, e regjistruar me Nr. biznesi FN 256166 s. Agrana ka një kompani të regjistruar në Kosovë ( në pronësi të plotë të ndërmarrjes së përbashkët Agrana Studen), **Agrana Studen Kosovo L.L.C.**, është kompani e regjistruar në Kosovë, me Nr. të biznesit 71358674 dhe adresë në; Rr. Njazi Alishani, Nr.4 Ban.2 10000, Prishtinë Kosovë, e cila si aktivitet primar ka shitjen e sheqerit në Kosovë.

**Beta Pura GmbH**, me adresë të regjistruar në Friedrich-Wilhelm-Raiffeisen-Plaza 1, A-1020 Vienna, Austri, me Nr. të regjistrimit të biznesit FN 509252a, e cila është në bashkëpronësi ndërmjet Agrana Sale & Marketing (ASM) dhe Amalgamated Sugar Company (ASC), ShBA, me adresë të regjistruar në 1951 S, Saturn Way Suite 100, Boise, Idaho 83709, ShBA, (ASC).

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksen administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja tre mijë Euro.

## **A r s y e t i m**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 02.03.2023, me Nr.Prot. 87/23-01/H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit përmes Përfaqësuesve Ligjor Z. Fisnik Salihu dhe Z. Kushtrim Palushi nga Shoqëria e Avokatëve RPHS Law, lidhur me Fitimin e Kontrollit mbi Beta Pura GmbH, nga ndërmarrjet Helix Beteiligungs GmbH (blerësi), Agrana Sale & Marketing GmbH, do ta ruaj strukturën e saj aksionare me 50% të aksioneve në Beta Pura.

### **Procedurat e ndjekura:**

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 14.03.2023.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së me dt. 09.03.2023
4. Më datë: 21.12.2022, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve të Beta Pura.

### **Baza juridike;**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c) Qarkullimi i palëve në tregun brendshëm e kalon shumën 3,000,000 Euro.
- d) Helix Beteiligungs GmbH, do të bëjë blerjen e aksioneve të Beta Pura, e cila së bashku me Agrana Sale & Marketing GmbH do të bëhen bashkëpronar.
- e) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë 21.12.2022
- f) Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se blerësi është prezent në Kosovë përmes shitjeve në mënyrë indirekte, ndërsa aksionari aktual ka filiale të regjistruar në Kosovë përmes një kompani të ndërlidhur.

## **Vlerësimi i Konkurrencës**

**Tregu Relevant:** Struktura e Helix Beteiligungs GmbH, Agrana Sale & Marketing GmbH në tregun e Republikën së Kosovës, nuk do të ndryshoj.

**Tregu i produktit** – është prodhimi dhe shitja e sheqerit, frutave dhe nishestes.

**Tregu gjeografik** – Tregu gjeografik mbetet i hapur.

## **Tregjet e Prekura**

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që pjesëmarrësit në përqendrim nuk operojnë në treg të njejtë të produktit dhe në tregun e njejtë përkatës gjeografik, dmth mes tyre nuk ka mbivendosje horizontale e as vertikale, shitësi nuk është aktiv në Kosovë pra nuk ka një filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe nuk është prezent as përmes shitjes, ndërsa pala blerëse është në mënyrë indirekte prezente në Kosovë përmes veprimtarive të ndryshme, ndërsa kompania ASM e cila ka qënë aksionare dhe vazhdon të mbetet do ta ruaj strukturën e njejtë të pozicionimit aktual në tregun përkatës kosovar.

## **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Austrisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se pala blerëse është prezente përmes shitjeve në Republikën e Kosovës në mënyrë indirekte, ndërsa pala e cila është dhe mbetet aksionare me 50% te aksioneve në kompanin (target), ka filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencë, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. dhe si e tillë nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.



**Shënim:**

Çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi dhe hyn në fuqi menjëherë, pas nënshkrimit nga Komisioni.

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiv

**Autoriteti i Konkurrencës  
Komisioni**



Neime Binaku - Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela  
Nënkryetare



Nafije Osdautaj  
Anëtare

